REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 6189 Prot

Maliq, më 19.11.2025

PROJEKT-VENDIM - NR. 7

"PËR
MBYLLJEN E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE MALIQ DHE KALIMIN PRANË STRUKTURËS SË BASHKISË MALIQ"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 64 gërma c, neni 54 gërma "dh", dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq Nr.98, date 30.09.2024 "Për krijimin e Agjensisë së Shërbimeve Mbështetëse"

PROPOZOJ:

1. Mbylljen e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe kalimin pranë strukturës së Bashkisë Maliq.

2. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e krijuara nga Agjencia e Shërbimeve Mbështetëse do të kalojnë në Bashkinë Maliq.

3. Struktura e Agjencisë së shërbimeve Mbështetëse do të kalojë pranë strukturës të Bashkisë Maliq në datën 01.01.2026.

4. Pagat e punonjësve të Agjencisë të muajit Dhjetor 2025 do të paguhen nga Bashkia Maliq.

5. Të bëhet çrregjistrimi i Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse në Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në datën 31.12.2025.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjensia e Shërbimeve Mbështetëse dhe Strukturat e Bashkisë.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 19/11/2025

Drejtori i Drejtorisë: G. Floqi Dt. 19/11/2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

6189

Maliq, më 19.11.2025

LËNDA: Relacion për mbylljen e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe kalimin pranë strukturës së Bashkisë Maliq.

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Maliq

Të ndruar Këshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 64 gërma c, neni 54 gërma "dh", dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq Nr.98, date 30.09.2024 "Për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse"

Të bëhet mbyllja e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe kalimi pranë strukturës së Bashkisë Maliq. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet të krijuara nga Agjencia e Shërbimeve Mbështetëse do të kalojnë në Bashkinë Maliq.

Pas një analize të funksionimit dhe rolit të Agjencisë Mbështetëse pranë Bashkisë Maliq, është konstatuar se aktivitetet dhe shërbimet që kjo agjenci ofron përputhen plotësisht me funksionet bazë të strukturave ekzistuese të administratës bashkiake. Për këtë arsye, vazhdimi i saj si një njësi e veçuar nuk paraqet më nevojë funksionale dhe krijon mbivendosje të kompetencave.

Me qëllim rritjen e eficiencës institucionale, thjeshtimin e procedurave, optimizimin e burimeve njerëzore dhe orientimin e të gjitha shërbimeve drejt një administrimi më të unifikuar, propozohet mbyllja e Agjencisë Mbështetëse si strukturë e pavarur dhe integrimi i plotë i saj brenda strukturës së Bashkisë.

Funksionet dhe detyrat e agjensisë do të transferohen pranë drejtorive dhe sektorëve përkatës të Bashkisë, duke siguruar vijimësi të pandërprerë të shërbimeve për qytetarët. Dokumentacioni, arkiva dhe inventari i agjensisë do të dorëzohen në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative në fuqi.

Ky ndryshim synon përmirësimin e koordinimit institucional, shmangien e dyfishimeve dhe forcimin e kapaciteteve të administratës bashkiake në shërbim të komunitetit.

Konceptoi: G. Floqi Dt. 19/11/2025
A. Muka Dt. 19/11/2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026